

Sot pas perëndimit të diellit, apo pas faljes së namazit të akshamit, fillon viti i ri i Hixhretit 1437.

Fjala arabe "Hixhret" nënkupton shpërnguljen e Profetit Muhamed dhe pasuesëve të tij nga Meka në Medinë, në vitin 622 të kalendarit gregorian.

Shpërngulja e Profetit Muhamed a.s. dhe muslimanëve të parë nga Meka në Medinë- Hixhreti, është pikënisja e llogaritjes së kalendarit musliman, kurse kjo ngjarje historike për muslimanët nënkupton fillimin e epokës së tyre.

Viti sipas Hixhretit zgjat rreth 354 ditë, dhe përbëhet prej 12 muajsh. Njëmbëdhjetë ditë është më i shkurtër se kalendari diellor.